



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 134 Akti

Nr. 65 Vendimi

Tiranë, më 13.09.2018

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Pamela Qirko
Etleda Çiftja
Firdes Shuli

Kryesues
Anëtar
Relator

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Ina Serjanaj, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Ferdinando Buatier de Mongeot, më datë 13.09.2018, ora 16:00, mori në shqyrtim çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj.Valbona Bala (Pajo), këshilltare pranë Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.**

OBJEKTI: **Ndërprerja e procesit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni G i Aneksit të Kushtetutës dhe neni 179/b, i ligjit nr. 76/2016, datë 22.07.2016, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar".**

TRUPI GJYKUESI KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Firdes Shuli, mori në shqyrtim dhe analizoi provat e faktet e mbledhura,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Znj. Valbona Bala Pajo, ka ushtruar funksionin e këshilltares së gjyqtarëve pranë Gjykatës Kushtetuese prej vitit 2008 deri në vitin 2017, dhe nga viti 2017 e në vazhdim, pranë projektit USAID-it.

2. Znj. Valbona Bala (Pajo) u shortua si subjekt rivlerësimi me shortin e hedhur më datë 15.05.2018, ku u caktua trupi gjykues i përbërë nga komisionarët, Firdes Shuli relatore, Pamela Qirko dhe Etleda Ciftja.

3. Me vendimin nr. 1, më datë 25.05.2018, trupi gjykues, vendosi:

3.1 Të caktojë kryesuese të trupit gjykues znj. Pamela Qirko.

3.2 Të fillojë hetimi administrativ për subjektin e rivlerësimit, znj. Valbona Bala (Pajo).

4. Pasi iu njoftua fillimi i procedurave për rivlerësimin e saj, më datë 25.06.2018, znj. Valbona Bala, iu drejtua Komisionit me kërkesë për qartësimin e pozicionit të saj në këtë proces, duke informuar se:

4.1 Ndërkohë që ligji nr. 84/2016 kishte hyrë në fuqi, ajo ka qenë në pozicionin e këshilltares në Gjykatën Kushtetuese dhe brenda datës 31.01.2017, ka dorëzuar pranë ILDKPK-së, DSIK-së dhe KLD-së, dokumentacionin e kërkuar në zbatim të ligjit nr. 84/2016;

4.2 Më datë 31 mars 2017 ka dhënë dorëheqjen nga funksioni këshilltares pranë Gjykatës Kushtetuese;

4.3 Në muajin shkurt 2018 ka shprehur interesin për pozicionin e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese;

4.3 Nuk ka rezultuar fituese për të vijuar trajnimin fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës.

5. Më datë 27.06.2018, znj. Valbona Bala, ka vënë në dispozicion të Komisionit, kopje të dorëheqjes së parevokueshme nga funksioni i këshilltares së gjyqtarëve në Gjykatën Kushtetuese, që mban datën 31.03.2018, si dhe urdhrin nr. 11, datë 20.04.2017, të kryetarit të Gjykatës Kushtetuese për lirim të saj nga detyra.

6. Këshilli i Lartë i Drejtësisë, me shkresën nr. 2049/2 prot., datë 27.06.2018, ka vënë në dispozicion:

- Kërkesën për dorëheqje të znj. Valbona Bala nga funksioni i këshilltares së Gjykatës Kushtetuese paraqitur kryetarit të Gjykatës Kushtetuese, z. Bashkim Dedja, më datë 31 mars 2017;

- Urdhrin e kryetarit të Gjykatës Kushtetuese, nr. 11, datë 20.04.2017, "Për lirim nga detyra dhe përfundimin e marrëdhënieve të punës".

7. Me shkresën me nr. 3461 prot., datë 17.04.2018, rezulton, se znj. Valbona Bala (Pajo) i është drejtuar Komisionit me një kërkesë për përditësim të dhënash të adresës elektronike, dhe informon për dorëheqjen e saj vullnetare nga funksioni i këshilltares së gjyqtarëve në Gjykatën Kushtetuese më datë 1 mars 2017, duke vijuar veprimtarinë profesionale pranë projektit USAID-it.

8. Më datë 06.09.2018, vëzhguesi ndërkombëtar, në zbatim të Aneksit të Kushtetutës, neni B, pika 3.b dhe ligjit nr. 84/2016, neni 49, pika 11, paraqiti opinionin e tij me shkrim lidhur me këtë çështje, sipas të cilit, procesi i rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, znj. Valbona Bala (Pajo) duhet të ndërpritet, në zbatim të dispozitave të nenit G të Aneksit të Kushtetutës.

II. ARSYETIM LIGJOR

1. Në përputhje me nenin 179/b pika 4, fjalia e parë e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, këshilltarët e Gjykatës Kushtetuese, janë subjekte të rivlerësimit që i përkasin kategorisë së rivlerësimit *ex officio*. Për këtë arsye, znj. Valbona Bala është subjekt rivlerësimi në momentin që ligji nr. 84/2016 ka hyrë në fuqi. Znj. Valbona Bala, ka dorëzuar brenda datës 31.01.2017 pranë ILDKPK-së, DSIK-së dhe KLD-së, dokumentacionin e kërkuar në zbatim të ligjit nr. 84/2016;

Neni G i Aneksit të Kushtetutës parashikon se : (1) *Subjekti i rivlerësimit mund të japë dorëheqjen nga detyra dhe në këtë rast procesi i rivlerësimit ndërpritet.* (2) *Subjekti i rivlerësimit që dorëhiqet sipas kësaj dispozite, nuk mund të emërohet gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15- vjeçare.*

Sipas kësaj dispozite, kuptohet qartë se, pasoja e dorëheqjes nga funksioni si këshilltarë ligjorë në Gjykatën Kushtetuese nga ana e subjektit të rivlerësimit, znj. Valbona Bala, (brenda tre muajve që ligji kishte hyrë në fuqi) është ndërprerja e procesit të rivlerësimit (neni G, pika 1) dhe ndalimi i emërimit të saj në një prej funksioneve gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, etj, për një periudhë 15- vjeçare (neni G pika 2) .

2. Në përputhje me nenin 179/b, pika 4, fjalia e dytë, procesit të rivlerësimit mund t'i nënshtrohen me kërkesë dhe nëse plotësojnë kriteret sipas ligjit edhe ish-këshilltarët ligjorë të Gjykatës Kushtetuese, të cilët kanë punuar në këto pozicione të paktën tre vjet. Pavarësisht se znj. Valbona Bala ka ushtruar funksionin e këshilltares në Gjykatën Kushtetuese, ajo nuk është subjekti rivlerësimi me kërkesë sipas kësaj dispozite, për arsyet si vijojnë :

2.1 Përveç faktit se nuk ka një kërkesë nga ana e saj për t'iu nënshtrohet procesit të rivlerësimit, ajo nuk mund ti nënshtrohet këtij procesi në cilësinë e ish-këshilltares (për efekt të ligjit nr. 84/2016), për arsye se faktikisht ajo nuk e gëzon këtë status, pikërisht për shkak të dorëheqjes së parevokueshme që ka dhënë nga funksioni i Këshilltares së Gjykatës Kushtetuese, në kohën që ligji ishte në fuqi.

2.2. Në shkresën e saj drejtuar Komisionit, më datë 27.06.2018, ajo parashtron ndër të tjera se: *“Procesi i rivlerësimit që Komisioni është duke kryer ndaj saj, nuk i takon për së paku fazës së rivlerësimit të subjekteve prioritare, e më së shumti as subjekteve ex officio e as atyre vullnetare”*. Znj. Valbona Bala, pranon se nuk është subjekt vullnetar vlerësimi sipas nenit 179/b të Aneksit të Kushtetutës.

2.3 Për sa më sipër, trupi gjykues, vlerëson se, vazhdimi i procesit të rivlerësimit me statusin e ish-këshilltares për subjektin e rivlerësimit Valbona Bala (Pajo), do të cenonte qëllimin e nenit G të Ankesit të Kushtetutës, pasi të gjithë subjektet e rivlerësimiti *ex officio*, pas dorëheqjes do të kishin të drejtë të bëheshin “subjekte rivlerësimi vullnetar”, ndërkohë që paragrafi i dytë i këtij neni, ndalon emërimin e tyre në ato funksione për një periudhë 15-vjeçare.

2.4 Në interpretim të dispozitave të mësipërme ligjore, trupi gjykues çmon se, subjekte vullnetarë sipas nenit 179/b, pika 4 të Kushtetutës, do të jenë vetëm ata të cilët kanë qenë “ish-gjyqtarë” ose “ish-këshilltarë ligjorë” në momentin e hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese, dhe që kanë punuar në këto pozicione pune të paktën për tre vjet. Si rrjedhim, znj. Valbona Bala, nuk e gëzon këtë status.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues mbështetur në nenin G të Aneksit të Kushtetutës,

V E N D O S I:

1. Të ndërpresë procesin e rivlerësimit kalimtar të znj.Valbona Bala (Pajo).
2. Ky vendim, i arsytuar, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtar dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe /ose Komisioneri Publik, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Pamela QIRKO
Kryesues

Firdes SHULI
Relator

Etleda ÇIFTJA
Anëtar

Sekretare
Ina SERJANAj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



VENDIM NR. 4

Tiranë, më 08.10.2018

TRUPI GJYKUES

Sot, më datë 08.10.2018, ora 15:00, trupi gjykues, i përbërë nga:

Pamela Qirko

Kryesuese

Firdes Shuli

Relatore

Etleda Çiftja

Anëtare

u mbledh për t'u njohur me kërkesën e relatores së çështjes, znj. Firdes Shuli, për korrigjimin e një gabimi material në vendimin e publikuar për subjektin e rivlerësimit, znj. Valbona Bala (Pajo).

Konstatohet se në vendimin nr. 65, datë 13.09.2018 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, znj. Valbona Bala (Pajo) ka një gabim material. Konkretisht në faqen numër 4, togfjalëshi "*Trupi gjykues, pasi administroi dokumentet, Aneks 1- dosja e ILDKPKI-së, Aneks 2 - dosja e Komisionit, mbështetur në nenin G të Aneksit të Kushtetutës...*", është shkruar gabimisht dhe duhet të ishte "*Trupi gjykues mbështetur në nenin G të Aneksit të Kushtetutës...*". Kjo për arsye se dosja e ILDKPKI-së dhe dosja e Komisionit, siç rezulton dhe nga përmbajtja e vendimit, nuk i kanë shërbyer trupit gjykues në procesin e vendimarrjes.

Bazuar në nenin 112 të Kodit të Procedurave Administrative: "Korrigjimi i gabimeve materiale në aktin administrativ", sipas të cilit përcaktohet se:

"1. *Organi publik, në çdo kohë, kryesisht apo me kërkesë, mund të korrigjojë gabimet e shkrimit, gabimet në përlllogaritje dhe pasaktësi të tjera të dukshme, në një akt administrativ.*

2. *Organi publik ka të drejtë të kërkojë kthimin e aktit administrativ të shkruar që korrigjohet, si dhe të çdo kopje të njëzuar të tij*",

trupi gjykues, konstatoi se kërkesa qëndron dhe pasaktësia është vendosur gabimisht gjatë zbardhjes së vendimit. Ndërkohë pjesa tjetër e vendimit është e saktë dhe e pandryshueshme.

PËR KËTË ARSYE

Bazuar në nenin 112 të Kodit të Proceduarve Administrative,

V E N D O S I:

1. Në faqen 4, të vendimit nr. 65, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit Valbona Bala (Pajo), togfjalëshi “*Trupi gjykues, pasi administroi dokumentet, Aneks 1- dosja e ILDKPKI-së, Aneks 2 - dosja e Komisionit, mbështetur në nenin G të Aneksit të Kushtetutës...*”, të zëvendësohet me togfjalëshin “*Trupi gjykues mbështetur në nenin G të Aneksit të Kushtetutës...*” .
2. Të njoftojë subjektin e rivlerësimit, Komisionerin Publik dhe Vëzhguesin Ndërkombëtar për këtë korrigjim.
3. Vendimi i korrigjuar të publikohet në faqen zyrtare të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Trupi gjykues nr. 4

Pamela Qirko

Firdes Shuli

Etlëda Çiftja

Kryesuese

Relatore

Anëtare



Sekretare gjyqësore

Anisa Duka